

ÇFARË DUHET TË DINI KUR NDËRVEPRONI ME PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Materiali informativ që do të gjeni më poshtë, është i përgatitur për t'i ardhur në ndihmë punonjësve të Policisë së Shtetit, kur atyre u duhet të komunikojnë dhe ndërveprojnë me persona me aftësi të kufizuara. Ai përmban një informacion të thjeshtuar mbi çështje të rëndësishme në fushën e aftësisë së kufizuar. Materiali përmban gjithashtu konsiderata etike të ndërveprimit me persona me aftësi të kufizuara, si edhe terminologjinë që duhet përdorur kur komunikojmë apo flasim për ta.

DISA ÇËSHTJE THELBËSORE QË DUHET TË DINI, KUR NDËRVEPRONI ME PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Aftësia e kufizuar është një karakteristikë themelore e jetës si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në zhvillim, dhe mund të ndikojë në jetën e gjithësecilit, në çdo moment dhe në çfarëdolloj shtrese qoftë. Askush nuk është i mbrojtur, dhe pothuajse gjithkush nga ne mund të ketë një eksperiencë të një aftësie të kufizuar në ndonjë moment të jetës. Aftësia e kufizuar nuk është një çështje, nga e cila do të donim të ishim të shkëputur apo të mos kishim asnjë lidhje, ajo është e ndërthurur me jetën tonë.

OBSH*

- Rreth 15% e popullsisë së botës jeton me një formë të aftësisë së kufizuar;
- Në shumicën e vendeve, gratë kanë norma më të larta të aftësisë së kufizuar se sa burrat;
- Ky grup përbën minoritetin më të madh;
- Kjo shifër është vazhdimisht në rritje/parashikohet rritje në numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë 30 viteve të ardhshme, veçanërisht në vendet në zhvillim, për shkak të kequshqyerjes, sëmundjeve, të punës së fëmijëve etj;
- 30% e fëmijëve të rrugës janë me aftësi të kufizuara;

UNICEF

- 90% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në vendet në zhvillim nuk ndjekin dot shkollën;

UNESCO

- Dinë të lexojnë dhe të shkruajnë vetëm 3% e të rriturve me aftësi të kufizuara në të gjithë globin;

ILO

- 80% e personave me aftësi të kufizuara, në moshë pune janë të papunë;

OBSH

- 25% të rasteve të aftësisë së kufizuar janë si rezultat i dhunës dhe keqtrajtimit;

UNDP

- Në vendet me jetëgjatësi mesatare të popullsisë mbi 70 vjeç, çdo individ kalon mesatarisht 8 vite apo 11.5% të jetës së tij me aftësi të kufizuara të përkohëshme;

TERMA TË RËNDËSISHËM TË FUSHËS SË AFTËSISË SË KUFIZUARA NË KUADRIN LIGJOR VENDAS

Arsim gjithëpërfshirës

Është një proces, i cili adreson dhe i përgjigjet shumëllojshmërisë së nevojave të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së përfshirjes në mësim, kulturë dhe në komunitet dhe për të reduktuar përjashtimin në edukim. Ky proces, përfshin ndryshime dhe modifikime në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji, me një vision, i cili përfshin të gjithë fëmijët e një moshe të caktuar dhe bindjes që është detyrim i shtetit që të edukojë të gjithë fëmijët.

Barierra

Janë pengesa, të cilat nuk lejojnë që personat me aftësi të kufizuar të jetojnë në mënyrë të pavarur, të punojnë, të udhëtojnë, të kenë akses në ndërtesa.

Braille

Është një sistem që i shërben shkrimit dhe printimit për persona të verbër, në të cilin shenjat e përdorura janë sisteme pikëzimi. Ky sistem shërben për të printuar dhe transkriptuar në teknikën Braille.

Diskriminim

Është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në ligjin 'Për mbrojtjen nga Diskriminimi', që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndër shkaqet e renditura në këtë ligj, është dhe aftësia e kufizuar.

Gjuha

Përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave, si dhe forma të tjera të gjuhës jo-të folur.

Gjuha e shenjave

Është sistemi i shenjave me lëvizje duarsh, që njihet dhe përdoret nga personat me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe në të folur.

Komunikim

Përfshin gjuhët, shfaqje teksti, Braille, komunikimin me prekje, printim me gjermë të madhe, multimedien dixhitale si edhe gjuhë të qartë, të dëgjuar dhe të shkruar, lexues, dhe mënyra, mjete dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, përfshirë informacion dixhital dhe teknologji komunikimi të përshtatshme.

Jetesë e Pavarur

Do të thotë, që personat me aftësi të kufizuara, kanë mundësinë për të zgjedhur vendin e tyre të banimit, ku dhe më kë do të jetojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe nuk janë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë të caktuar jetese. Personat me aftësi të kufizuara kanë akses në një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbime rezidenciale dhe shërbime në komunitet, duke parandaluar izolimin dhe veçimin nga komuniteti. Shërbimet dhe mjetet komunitare për popullatën në përgjithësi janë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara që i përgjigjen nevojave të tyre.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)

Është një marrëveshje formale mes shteteve. Është një konventë e negociuar për një periudhë prej 5 vitesh, e cila u miratua në vitin 2007 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe hyri në fuqi në vitin 2008. Konventa mbështetet në traktatet ekzistuese të të drejtave të njeriut. Ka si qëllim kryesor mbrojtjen efektive të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe të garantojë të drejtat e tyre të njeriut. Konventa ka fuqi detyruese mbi Shtetet të cilët janë palë të saj. Shqipëria e ka ratifikuar KDKPAK në vitin 2012.

KMKAP Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë (rajonale)

KMKAP është organ mjekësor dhe ligjor që e mbështet veprimtarinë e tij në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe në kriteret e caktimit të aftësisë për punë.

KMKAP Epror Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë

KMKAP Epror ngrihet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH. Numri llojet e specialiteteve dhe anëtarët e komisioneve caktohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe miratohet nga Ministria e Shëndetësisë. KMKAP Epror shqyrton dhe zgjidh kërkesat e individëve, që apelojnë vendimet e KMKAP rajonale, si dhe shqyrton dhe zgjidh rastet e dërguara me divergjencë nga KMKAP rajonale.

Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuara

"Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuara" është një ekip i përzgjedhur, me mjek dhe punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë drejtorisë rajonale të Shërbimit

Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për procesin e vlerësimit biopsikosocial të aplikuesve për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga mjekët, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara dhe verifikimin e informacionit me institucione të tjera.

Kujdestar Ligjor

Gjykata, në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar. Dispozitat e kujdestarisë për të miturit zbatohen edhe për kujdestarinë e personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. Kujdestari i personit, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, përfaqëson dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi përfaqëson dhe administron pasurinë e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç. Kujdestari i personit, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, jep pëlqimin dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi jep pëlqimi dhe administron pasurinë e të miturit që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç.

Kujdes i përkohshëm (respite care)

Kujdes në një kohë të shkurtër ose kujdes i përkohshëm për persona me aftësi të kufizuar, me qëllim, që familjarët apo kujdestarët e tyre, të pushojnë nga stresi i përditshëm që lidhet me përkujdesjen, që zgjat duke filluar nga disa orë deri në tre muaj. Në ndryshim nga përkujdesja ditore, kjo formë kujdesi, mund të jepet edhe gjatë natës.

Modeli mjekësor/Qasja mjeksore

Modeli mjekësor paraqet aftësinë e kufizuar si problem të personit, të shkaktuar në mënyrë të dejtëpërdrejtë nga sëmundja, trauma apo gjendja mjekësore, dhe kërkon kujdes mjekësor të vazhdueshëm nga profesionistë të mjekësisë. Sipas modelit mjekësor, aftësia e kufizuar duhet të kurohet.

Modeli Social/Qasja Sociale

Modeli social e paraqet aftësinë e kufizuar si problem social dhe çështje të integritit të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri. Sipas këtij modeli, aftësi e kufizuar nuk është një cilësi e personit por janë disa kushte dhe rrethana, shumë prej të cilave janë të krijuara nga ambienti rrethues. Sipas këtij modeli, kërkohet ndryshim i shoqërisë dhe është detyrim i saj të bëjë modifikimet e nevojshme, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të jenë pjesëmarrës në të gjithë fushat.

Modeli Bio-Psiko-Social/Qasja bio-psiko-sociale

Modeli bio-psiko-social e paraqet aftësinë e kufizuar si një ndërveprim i gjendjes shëndetësore apo dëmtimit të individit me faktorët mjedisorë dhe ato personal.

Ndihmës personal

“Ndihmësi personal” është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.

Pension invaliditeti

Personi që bëhet i paaftë, merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:

- a) për çdo veprimtari ekonomike;
- b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

Për më shumë shih ligjin “për Sigurimet Shoqërore “7703, datë 11.05.11993, i ndryshuar, neni 35 e në vijim.

Pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar

Përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar janë përkufizuar si përfitime në para dhe/ose shërbime të dhëna tek individët, të cilët janë vlerësuar të përshtatshëm për t’i përfutur dhe që synojnë:

- Të ndihmojnë për të mbuluar shpenzimet që lidhen me aftësinë e kufizuar
- Të sigurojnë përfshirjen sociale
- Të sigurojnë në mënyrë progresive mirëmbajtjen e cilësisë së jetës që është e krahasueshme me standartet e vendit

Përshtatje e arsyeshme/ Mohim i përshtatjes së arsyeshme

Eshtë ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë, kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Projektim universal

Do të thotë projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t’i bërë ato të përdorshme nga të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë. “Projektimi universal” nuk duhet të përjashtojë paisjet asistuese për grupet e veçanta.

Përfshirje/rrymëzim i çështjeve të aftësisë së kufizuar

Rrymëzimi i aftësisë së kufizuar mund të përcaktohet si si një integrim sistematik i prioriteteve dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha politikat dhe masat, nga faza e planifikimit, përgjatë zbatimit, monitorimit dhe deri në vlerësim.

Protokoll Opsional

Ky term nënkupton një instrument ligjor shtesë, i cili plotëson dhe i bashkangjitet traktatit ndërkombëtar (Konventë). Protokollit mund të lidhet me ndonjë temë e lidhur me traktatin origjinal dhe përdoret për të adresuar një çështje të caktuar të traktatit, adreson ndonjë shqetësim të traktatit ose krijon një procedurë për të përforcuar zbatimin e traktatit.

Persona me Aftësi të Kufizuara

“Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë

ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Vendim-marrje e mbështetur

Mund të ketë disa forma. Ata që mbështesin personin mund t'i komunikojnë të tjerëve qëllimet e personit ose të personin të kuptojë zgjidhjet e ndryshme. Personat mbështetës mund të ndihmojnë gjithashtu të tjerët të kuptojnë që personi me aftësi të kufizuara (domethënëse në këto raste) ka gjithashtu një histori të vetën, preference dhe objektiva dhe që është i aftë të ushtrojë zotësinë juridike.

Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar

“Vlerësimi biopsikosocial” është një proces vlerësimi i faktorëve të ndryshëm dhe të ndërvarur, të cilët përcaktojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Këta faktorë janë: struktura trupore, funksionet trupore e psikologjike, si dhe faktorë personalë, shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë.

Sisteme të dëgjimit/aparate

Janë pajisje të cilat multiplifikojnë tingujt ose zërin, që ndihmojnë personat me aftësi të kufizuar në dëgjim.

Shkollë speciale

Shkollë e posaçme për fëmijë me aftësi të kufizuara, kryesisht me aftësi të kufizuar mendore por edhe forma të alternuara të aftësisë së kufizuar mendore dhe asaj fizike. Këto shkolla, funksionojnë në bazë të kurrikulave të veçanta.

Teknologji asistuese/ ndihmëse

Pajisje, të cilat përdoren nga personat me aftësi të kufizuar për të kompensuar kufizimet funksionale, që ata kanë, dhe që i ndihmojnë ata për të zgjeruar dhe për të rritur aftësitë njihëse, pavarësinë, lëvizshmërinë, komunikimin, zgjedhjet e tyre dhe kontrollin e ambientit rrethues.

Terapi okupacionale

Terapia okupacionale është një shërbim profesional shëndetësor, i fokusuar tek klienti, dhe që ka për qëllim kryesor promovimin e shëndetit përmes zënies me punë të klientit. Qëllimi kryesor është i terapisë okupacionale është që të mundësojë njerëzit të marrin pjesë në aktivitetet e jetës së përditshme.

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit dhe Aftësisë së Kufizuar i OBSH (KNF)

Përbën bazën për përcaktimin dhe vlerësimin e aftësisë së kufizuar. KNF është i organizuar në tre komponentë: (i) struktura dhe funksionet e trupit; (ii) aktivitetet e jetës së përditshme dhe pjesëmarrja në veprimtari në përputhje me moshën; (iii) faktorët mjedisorë.

Nxënës me aftësi të kufizuara

Është personi i cili, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimin e tij dhe në jetën shoqërore.

Nxitje për punësim

Janë programet dhe projektet qeveritare, të cilat synojnë nxitjen e punësimit

NDËRVEPRIMI ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ndërveprimi me personat me aftësi të kufizuara nuk kërkon aftësi të veçanta, po duhet të jetë njëlloj si kur ndërveprohet me një person pa aftësi të kufizuara. Më poshtë, janë disa rregulla bazë të etikës, kur një gazetar ndërvepron me një person me aftësi të kufizuara.

- Mendohuni përpara se të flisni;
- Pyeteni personin me të cilin po flisni për gjithçka që ju jeni i/e pasigurt;
- Shiheni personin në sy kur flisni me të, pavarësisht se mund të jetë duke përkthyer një përkthyes i gjuhës së shenjave;
- Gjithmonë drejtojani komentet, pyetjet dhe shqetësimet direkt personit që nuk dëgjon dhe me të cilin po komunikoni;
- Përdorni tonin tuaj normal dhe mos bërtisni;
- Mos shprehni ndjenja të keqardhjes;
- Ofroni ndihmë, duke pyetur me parë personin nëse ka nevojë për të;
- Është shumë e rëndësishme të identifikoni veten kur i afroheni një personi me aftësi të kufizuara në shikim, dhe t'i tregoni atij, kur vendosni të largoheni nga biseda apo ambienti;
- Ofroni krahun dhe i lejoni personit me aftësi të kufizuara në shikim, t'ju drejtojë ai, kur e ndihmoni gjatë lëvizjes. Mos shtyni, apo mos e tërhiqni personin apo pjesë të trupit të tij dhe përpikuni t'i udhëhiqni ata.

Terminologjia

Terminologjia, që përdoret kur flitet për aftësinë e kufizuar, luan një rol shumë të rëndësishëm në mënyrën se si shoqëria i shikon dhe i trajton personat me aftësi të kufizuara. Ajo është e rëndësishme, kur ndërveprohet me personat me aftësi të kufizuara.

Përdor gjithmonë termin/fjalën 'person' përpara	Mos përdor terma që etiketojnë
Person/ individ me aftësi të kufizuara Person që ka një dëmtim	Handikapat
Persona pa aftësi të kufizuara	Person normal Individ i shëndetshëm Pa dëmtim në trup (Kujdes, këto terma nuk duhet të përdoren kur jemi duke folur në kontekstin e aftësisë së kufizuar, pra kur krahasojmë.)

Person me vështirësi në të mësuar Person me aftësi të kufizuara mendore/ intelektuale Person me sindromen Down Person me aftësi të kufizuara psiko-sociale	Person me zhvillim të vonuar mendor Është i vonuar/ I vonuari Është down; mongoloid; Handikapat mendor Person me shëndet mendor
Person me çrregullime të spektrit të autizmit	Autist
Person, i cili ka ADHD	Ai/Ajo është me çrregullim hiperaktiv të vëmendjes
Person me vështirësi në komunikim, vështirësi në të folur/ person që nuk flet	Nuk artikulon; gagac
Person me vështirësi në dëgjim ose me humbje të dëgjimit	Shurdh
Person me dëmtim në shikim; Person i verbër Person me shikim të pjeshëm;	Ai që nuk shikon; qorri
Person që ka epilepsi	Epileptik
Person që përdor karrike me rrota Person që ka dëmtim në lëvizje	I paralizuar I destinuar për të qëndruar në karrike me rrota
Person me tetraplegji/Paraplegji	Tetraplegjiku/Paraplegjiku
Person me trup të shkurtër	Shkurtabiq
Person me një aftësi të kufizuar të lindur	Ka difekt në lindje
Autobuzë të përshtatur; tualete të përshtatur, dhoma hotelesh të përshtatura etj. Vend parkimi i përshtatur për persona me aftësi të kufizuara	Autobuzë, tualete dhe dhoma hotelesh për handikapatë; Vende parkimi për handikapatë;

Ky material informues është përgatitur në kuadrin e Projektit “Policimi në Komunitet dhe Aftësia e Kufizuar – Partneritet për Përfshirje”, me mbështetjen e FCG Swedish Development AB/PMT dhe përmes financimit të Qeverisë Suedeze.

Përmbajtja e këtij udhëzuesi është përgjegjësi e FSHDPAK dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e FCG Swedish Development AB/PMT apo të Qeverisë Suedeze.

Për më shumë informacion kontaktoni:

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rruga: Bogdani, Nr 1, Tiranë - Shqipëri

Tel: +355 0 4 2 269426

Email: adrf@albmail.com